



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 04/2014
Prishtinë, më 19.1.2015, në orën 15:15
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Visar Ymeri, Sasha Milosavljeviq, Sala Berisha-Shala, Besim Beqaj, Raif Qela, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Pal Lekaj dhe Fatmir Limaj, anëtarë.

Mungoi: Duda Balje, anëtare.

Pjesëmarrës të tjerë: Lejla Selimi, OSBE.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetari i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr.05/L-08 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-035 për riroganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre;

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr.05/L-08 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-035 për riroorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se sot kemi në rend dite shqyrtimin në parim të Projektligjit nr.05/L-08 , ër ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për riroorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, ku me herët në seancë dëgjua edhe arsyetimin që e dha zoti Kryeministër, pra ne presim që edhe Ligji tjetër të vijë në procedurë dhe tani e kemi edhe ministrin z.Stavileci këtu për të dhënë arsyetimin e këtij projektligji.

Blerand Stavileci, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE), tha se duke e analizuar në ndërkohë gjendjen dhe faktet si dhe efektet e mundshme të kalimit të atij Projektligji, në këtë kohë, pa pasur pararojë në kuptimin kohor na është dashur që të bëjmë edhe zgjidhje të tjera, me të cilat e parandalojmë zbatimin e Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme. E vetmja mundësi që kemi mundur të bëjmë, ka qenë Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për riroorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara të pasurisë së tyre, dhe atë siç e shihni brenda përmbajtjes së këtij materiali, në dy nene, në Nenin 22 dhe në Nenin 41. Pra Neni 22, i cili lidhet me periudhat kohore brenda të cilave duhet të dorëzohet nga ana e administratorit, Plani për riroorganizimin dhe planet alternative për riroorganizim dhe Neni 41, i cili ka në veti pjesën e kalimit në likuidim. Pra, te Neni 22, kemi bërë një plotësimin dhe ndryshimin që kryesisht lidhet me afatet kohore, duke i zgjatur ato, nga 18 muaj dhe tjetra në 36 muaj, e që i bie se vendimi do të hyjë në fuqi, po që se nuk do të reagonim në deri më 2 shkurt të vitit 2015. Ne jemi konsultuar me ekspertë ligjorë, të cilët na kanë thënë se po që se e bëjmë një transformim të tillë, pa i analizuar mirë të gjitha faktet dhe rrethanat dhe efektet potenciale negative që mund të ketë, ne rrezikojmë që të gjitha kërkesat e kreditorëve të bien mbi barrën tonë dhe ta rrezikojmë falimentimin e shtetit, buxhetit të shtetit, pra të vet shtetit. Prandaj kemi dashur që si hap i parë ta evitojmë falimentimin, kurse si hap i dytë, ta kemi bashkërisht Kuvendi me Qeverinë një strategji dhe një Ligj të veçantë për “Trepçën”. Dhe unë tash po vi nga mbledhja e Qeverisë, ku ne e proceduam përsëri plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, tha ministri Stavileci.

Muhamet Mustafa, kryetar tha se ne edhe gjatë diskutimit e kemi shikuar edhe Nenin 5 edhe nenin që ka pasur të bëjë me kreditorët, që ka pas paqartësi dhe kemi kërkuar që deri në mbledhjen e ardhshme kjo të sqarohet. Po ashtu e përsëritëm Qeverinë që e procedon Ligjin me të cilin çështja e “Trepçës” nuk do të lihet status-quo, por për këtë Ligj do të diskutojmë kur të na vijë. Ne sonte e kemi këtë edhe duhet ta procedojmë dhe ta fusim në procedurë urgjente. Po ashtu kemi vetëm 13 ditë dhe ky ligj duhet të hyjë në fuqi. Shkojmë me procedurë urgjente në Kuvend të aprovohet sot dhe ma merr mendja se leximi i dytë do të botohet në gazetën zyrtare.

Visar Ymeri tha se dua ta potencojë që memorandumit shpjegues që e keni dorëzuar, së bashku me Ligjin, titullin e ka gabim, pra është Ligji për efikasitet të energjisë, dhe përmbajtja po ashtu është e ligjit, e jo e këtij projektligji dhe vetëm desha ta potencojë sepse ky është dokument zyrtar, pra që duhet të na dërgoni memorandumin shpjegues të ligjit në fjalë. Pastaj, sa i përket kësaj se çka është propozuar në këto dy nene, sepse po kuptohet se çka ka qenë qëllimi ngase jemi duke folur për një periudhë kohore shumë të shkurtër, ku unë mendoj se nuk ka mundur dikush me shkop magjik të ndryshojë gjërat në fund të javës.

Pyetja ime do të kishte qenë kjo: ky Ligj a e shndërron “Trepçën” në ndërmarrje publike si të tërë, me këtë që po e përgatisim, apo do t’i shndërron vetëm pjesë të caktuara të “Trepçës” në ndërmarrje publike? Duhet të dihet që pozicionimi karshi këtyre ngjarjeve varet drejtpërdrejt edhe nga kjo sikurse edhe e nesërmja për këtë ndërmarrje. Unë po ashtu mendoj se pavarësisht kësaj, këto mund të jenë vetëm spekulime mediale, por është shumë e qartë që ka pasur një ndërhyrje dhe ju duhet të na tregoni se çka ka qenë ajo ndërhyrje dhe deri në ç’masë ju jeni

pajtuar më të, sepse u bë zhurmë e madhe gjatë javës nga Serbia edhe nga pozicioni kundër i Listës Serbe. Ndërsa tash u shndërrua në një pozicion që po e pranon. Pra çka ka ndodhur?

Blerand Stavileci, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE), **tha se** në mbledhjen e kaluar u diskutua për një formulim, sa i përket detyrimeve dhe u dakordua dhe unë tregova se si e kishim paraparë se si të vepronim. Pra, unë këtu kam edhe një përmbledhje të kërkesave të kreditorëve të “Trepçës”, që është në total 1 miliard e 34 milionë euro, dhe një transformim i tillë, një titullar i ri, siç ne e mendonim, pra neve na vënin në një pozicion të vështirë, për ta rrezikuar buxhetin dhe qëndrueshmërinë buxhetore, falimentimin edhe të vet shtetit. Dhe, besoj që asnjëri nuk do ta donte këtë dhe kemi disa raste, kemi në Slloveni mund ta verifikosh një rast të tillë kur kreditorët pasi që titullar ka qenë shteti një ndërmarrje, nga shoqërore është transformuar në publike, dhe u janë vënë në shpinë. Ka pasur kërkesa të kreditorëve dhe gjykata i ka vërtetuar dhe i ka autorizuar si të tilla. Për të mos marrë një barrë të tillë me rekomandime të ekspertëve ligjorë, ne e kemi sjell tani këtë projektligj. Pra, kjo është arsyeja kryesore pse kemi punuar me një pistë ku mjetet e punës i kemi bartur në pistën tjetër, pra pa e braktisur të parën por vetëm për ta shpëtuar nga likuidimi e pastaj të kalojmë në tjetrën zgjidhje, për të gjetur një rrugë më të mirë. Sepse edhe ndaj atyre mjeteve që janë vitale sot, gjashtë njësitë kryesore, minierat me flotacion, metalurgjia dhe industria kimike, edhe ndaj tyre ka kërkesa të kreditorëve. E di që vetëm ndaj njëres, janë diku 43 milionë, por prapë ajo pjesa tjetër që do mbestë në administrim të AKP-së, në këtë mënyrë ne do hynim në një situatë absolutisht të mjegulluar dhe të panjohur për të gjithë neve. Si hap i parë për ta evituar Vendimin e Gjykatës që të mos shkohet në likuidim, me plotësim ndryshimin e ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara të pasurisë, duke e prekur Nenin 22 dhe Nenin 41, ne e bëjmë një gjë të tillë dhe pastaj kalojmë në këtë hapin e dytë, që me siguri merr më shumë kohë, deri sa të vijmë te një zgjidhje meritore për këtë kompleks të rëndësishëm.

Muhamet Mustafa, kryetar, tha se natyrisht kjo çështje është shumë e rëndësishme dhe mund ta debatojmë. Është evident rreziku i falimentimit, ndërsa me këtë ligj ne duhet ta evitojmë falimentimin, pra ky është qëllimi. Ndërsa duhet të vije Ligji, i cili e obligon Qeverinë dhe Kuvendin, që të del me strategji për konsolidimin dhe strukturimin e Trepçës, sepse aty do të jenë studimet e fizibilitetit, prandaj unë ju kisha lutur që çështjet se qysh do të duket Ligji për “Trepçën” të mos i diskutojmë për arsye se ai Ligj kërkon përgatitje dhe studim shumë të thellë.

Besim Beqaj, theksoi se edhe në mbledhjen e kaluar e kam potencuar që nuk jam i kënaqur me amendamentimin e ligjit paraprak, posaçërisht në pjesën që ka të bëjë me kreditorët dhe arbitrazhin dhe potencialin e bartjes së rrezikut nga një nivel të ndërmarrjes shoqërore, në ndërmarrje publike. Nuk do të hy se sa janë kreditorët potencial edhe pse nga pak po manipulohet me atë se kemi kaq apo aq borxhe. Duhet të themi që janë vetëm të evidentuar, a janë pretendime të cilat kanë verifikim dhe ne në asnjë rrethanë nuk guxojmë të biem pre e asaj se ndoshta janë pretendime dhe besoj që pretendimet janë të pa argumentuara. Për këtë arsye unë jam në parim që të shkohet në këtë rrugë, të bëjmë diçka sepse çështja është emergjente dhe mos të hyjmë në hapa të shpejtë, se po na formohen dëme kolaterale, sepse nëse ne po bëjmë Ligje të përshpejtuara, që do të ishte diçka jo e mirë, ngase “Trepça” nuk është ndërmarrje si çdo ndërmarrje tjetër, tha Beqaj.

Fatmir Rexhepi tha se ë këtë situatë që jemi, nuk ka dilemë që parandalimi është prioritet i parë. Pajtohem edhe në variantin që është ofruar, që të mos shkojë në likuidim por ti jepet një rast edhe Qeverisë edhe AKP-së ta mbushin planin strategjik dhe mos të na ndodhë sepse tash tre-katër vite kjo punë është zvarrit në mes të Qeverisë, Bordit të AKP-së dhe vonesat janë shkaktarë kryesor që ndoshta e kanë prurë deri këtu, e tani pasojat janë këto që janë. Ajo që mua po më habit dhe që ende kam dilema të mëdha, shtrihet një pyetje shumë e thjeshtë, po që se nuk ka kurrfarë pasurie “Trepça”, në qoftë se “Trepça” nuk paska resurse brenda saj, atëherë çka

i duhet “Trepça”, as brenda Kosovës as Serbisë, se di pse. Në qoftë se i paskemi 1 miliard borxh dhe 500 pretendues, ndoshta nuk janë asnjë, por po supozojmë që janë, atëherë cila është pasuria e “Trepçës”? Nëse është 10 miliardë ose 5, apo nëse është ma pak se ajo, pra po shkojmë që ne duhet vet ta bëjmë likuidimin, nuk ka nevojë askush të na detyrojë ta bëjmë këtë punë. Por, unë po dua t’ua jepi një vërejtje të gjithë neve të cilët tash 14 vjet jemi edhe sa 40 vjet sa kemi punuar në Kosovë, inxhinierë, teknolog, ekonomistë e juristë, asnjëherë nuk u gjet asnjë institucion relevant deri më sot që të ketë një vlerësim të përafërt lidhur me “Trepçën” dhe të thuhet se kjo është pasuria reale, e cila është hulumtuar në bazën e së cilës ne mundemi me marrë një vendim të drejt. Kjo ishte dilema ime, tha në fund Rexhepi.

Raif Qela tha se me këtë Projektligj parandalohet likuidimi i “Trepçës” dhe që është çështja më e rëndësishme për të cilën jemi mbledhur. Kuvendi edhe Qeveria po punojnë, pavarësisht se ky gabim në adresë të kujt i faturohet. Mendoj se ka qenë hap më se i domosdoshëm të ndërmerret diçka për likuidimin, i cili sipas Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, më 2 shkurt skadon afati. Projektligji, i cili synohet të vije në rend ditë për nesër në mëngjes. Besoj që nuk dallon qenësisht shumë nga ai i mëparshmi në përjashtim të asaj që mënjanon dilemat rreth gjyqit të arbitrazhit, por duhet të shikohet mirë se në atë ligj a është përmendur fare mirë “Trepça” sepse në pjesën e parë përderisa përmendet Qeveria, Qeverisë i jepet mundësia të propozojë ndërmarrjet e veçanta shoqërore, të shndërrohen në ndërmarrje publike, ndoshta nuk është e thënë që të përsëritet dhe të thuhet enkas vetëm për “Trepçën”, sepse ajo nënkuptohet.

Pal Lekaj tha se vet Qeveria e ka prurë gjendjen e cila nuk është e favorshme dhe tani po mundohet të bëjë diçka që nuk do të jetë e pranueshme. Dhe në qoftë se dikush është marrë me Ligjin për ndërmarrjet Publike, ne jemi marrë bukur mirë disa herë dhe e dimë se cili është qëllimi i ndërmarrjeve publike. Por duhet thënë troç qytetarëve, se cili është qëllimi, dhe se në këtë vend e kemi një ministër nga qeveria e Serbisë dhe krejt kjo gjendje nuk do të jetë e favorshme për qytetarët e Kosovës dhe në tërësi për të mirën e “Trepçës”. Ne e kemi një kronologji, të cilën e ka bërë Agjencia i Privatizimit, të cilën e kemi proceduar këtu dhe të gjithë unanimisht jemi pajtuar, pra çka ndryshoi? A ndryshuan njerëzit, apo duhet të thuhet troç që është vendim i Serbisë që mos të merremi me “Trepçën”. Shikoni deklaratat që i kanë bërë dje, ministrat tonë në qeverinë e Serbisë, dhe kanë thirrë protesta, të cilat janë zhvilluar. Ndërsa tani na del një ndryshim i këtij ligji përshkrim i kornizës ligjore, i cili përcakton rregullat dhe procedurat për riorganizim dhe likuidim, tha Lekaj.

Muhamet Mustafa, kryetar, tha se çështja është shumë serioze. “Trepça” është një çështje shumë serioze, prandaj nuk jemi këtu të mbajmë fjalime të nxehta politike. Ne nuk duhet të mashtrohemi se çka thotë Vuçiqi. Vuçiqi e dinë mirë se “Trepça” s’është e tij, se krejt kreditorët e tij kanë ardhur te institucionet e Kosovës dhe janë paraqitur me kërkesa këtu. Po të ishte “Trepça” e tij, ata kishin shkuar tek Vuçiqi, por ata kanë ardhur te ne, prandaj, po them që këto janë gjëra politike dhe nuk ka aty asgjë, për atë po them të mos biem në atë eufori, dhe ne duhet të përqendrohemi ta mbarojmë punën tonë dhe nuk ka nevojë të bazohemi në fjalimet, të cilat vijnë nga ta, tha Mustafa.

Blerim Grainca tha se është e vërtetë që Qeveria ndoshta është ngut pak, por qëllimi ka qenë i mirë gjithsesi, edhe ne të gjithë jemi ngut me procedimin dhe me e shqyrtua sepse edhe ne kemi deshtë që t’ia rikujtojmë Qeverisë se kjo mund të rregullohet me këtë Projektligjin tjetër, prandaj nuk do të duhej të merremi shumë se e kujt është përgjegjësia, me rëndësi është se po arrihen efektet, po parandalohet likuidimi i “Trepçës”. Mendoj se duhet të themi haptas, ai ka qenë qëllim politik, i asaj Gjykate, dhe dihet kush janë anëtarët e kësaj Gjykate, dihet se kush i sponsorizon dhe kush i pagan ata. Prandaj, është shumë e qartë kjo punë. E dyta, është pyetje për ministrin, se a ka ide apo një plan apo një deadline (afat të fundit), kur duhet të vijë Ligji tjetër në diskutim?

Blerand Stavileci, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE), tha se desh me i nda edhe shqetësimet e deputetit z.Pal Lekaj, kështu pa emocione të diskutojmë sepse për të gjithë njëjtë është e rëndësishme kjo çështje. Për sa i takon Ligjit për ndërmarrjet publike, ne e kaluam sot në Qeveri dhe shumë shpejt do të vijë sepse ai meriton një trajtim urgjent. Por, sot siç e dini e kemi seancën për këtë projektligj, dhe për atë që ju tani kërkon do ta kemi në tjetrën seancë, gjë të cilën nuk e di saktë, por do t'ua them ditëve të ardhshme duke filluar prej nesër.

Fatmir Limaj tha se sot jam këtu për herë të parë para jush në Komision dhe herën e kaluar Projektligji që është dhënë i pari, është miratuar nga ky Komision, nga ju këtu, pse ndryshoi pozicioni brenda dy ditësh, është diçka interesante, mund të them një metamorfozë ne mes nesh se çka po ndodh. Mendoj se nuk është punë Qeverie këtu, as punë deputeti, pozitë opozitë, por është çështje politike deri në fund “profë”, asgjë s’ka këtu ekonomi, krejt është politikë. Unë mendoj që Qeveria ka bërë veprim të mirë me atë Projektligjin e kaluar për ta shndërruar “Trepçën” në ndërmarrje publike, dhe diçka e mirë që ka mundur të ndodh në aspekt të ekonomisë të këtij vendi, po them në propozimin e parë jo atë të sotmin. Çështja e kalimit të “Trepçës” në ndërmarrje publike apo likuidimit të saj me 2 shkurt, këtu më shumë po shoh një interes momental, thjesht me e zvarrit. Dhe esenca nuk është vetëm për ata tre- katër mijë punëtorë, por është esenca edhe e pasurisë së këtij vendi. Kjo çka po na ofrohet neve sot është t’ia shtyjme punëtorit, ashtu që mos t’i largojmë nga puna, mandej pas gjashtë muajve, ta shohim se çka po vendosim. Me këtë çka po bëhet sot dhe se çka mund të bëhet nesër dhe pasnesër, ne po e hapim rrugën për me u bisedua në Bruksel për “Trepçën”, të shtrohet si temë e diskutimit atje. Ne, në vitin 2007, e kemi pasur këtë çështje në diskutim, ku besoj një pjesë e juaj ka qenë atje, dhe në Pakon e Ahtisarit është mbyll, mirë e thatë që çështja e pasurisë së Kosovës është e mbyllur, por më 9 shkurt do të hapet përsëri, sepse pakoja e Ahtisarit është hap, por unë nuk po dua që ti hy asaj teme, sepse është temë e madhe, dhe kjo është vazhdim i hapjes së pakos së Ahtisarit. Kjo çka po bëni sot është me la ujin me akull. Ajo që ka bërë herën e kaluar Qeveria, ka qenë mjaftë mirë e menduar, është veprim më i mençur, por këtë çka po doni ta bëni ju sot nuk munden ta mbajnë as tri ditë, sepse nesër në Bruksel ka me tu hap çështja vetëm e “Trepçës”. Jemi dëshmitarë, presim e shohim dhe ne thjeshtë po i japim mendimet tona por të paktën mos na fyeni inteligjencën. Ajo çka unë po mendoj, është kështu që janë disa gjëra që nuk shkojnë me votë. Kjo çka po bëjmë sot, ka mu shit se po e shpëtojmë për një gjashtë muaj. Kjo çka po bëjmë është edhe ndërhyrje drejtpërdrejt edhe në gjykatë. Praktikisht, shumë më mirë është mbrojtur pasuria e Kosovës në kohën e autonomisë në vitet 89, se sa që jemi sot duke e mbrojtur atë, dhe mos e harroni, këtu s’ka pozitë, s’ka opozitë dhe e di se asnjë nga ne s’jemi për këtë Ligj, theksoi Limaj.

Muhamet Mustafa, kryetar tha se sot nuk mund të projektojmë se çka do të ndodhë apo se si do të veprojë Serbia dhe nuk mundemi të spekuojmë, por unë e di vetëm një gjë, se ky vend e ka shpallë pavarësinë, i ka organet, e ka Kushtetutën dhe i ka të gjitha gjërat për me e mbrojtë pronën e vet. Dhe jam i bindur që ky Kuvend dhe të tjerët, nuk kanë me ra në atë provim dhe do ta mbrojnë pronën e vetë, prandaj, ta shohim se si është mënyra më e mirë për veprim, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat.

Sala Berisha Shala, theksoi se duke marr parasysh rëndësinë e këtij takimi urgjent dhe të jashtëzakonshëm, në shikim të parë është vënë në pikëpyetje kredibiliteti i Komisionit, Qeverisë dhe i Parlamentit. Me këto ndryshime që po i bëjmë, por mendoj se kjo nuk është ajo që duhet të na vras neve të na pengojë në njëfarë forme në punën tonë. Por, ne duhet të ia rikujtojmë vetvetes se është pako ligjore, që janë tri ligje, Ligji për AKP-në, Ligji për Ndërmarrjet Publike dhe Ligji për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe të pasurive të tyre, gjithsesi reflektojnë tek njëra- tjetra, sepse janë të ndërlidhur dhe cili do që të bie me ndryshua, domosdoshmërisht e kërkon urgjentisht ndryshimin e Ligjit tjetër, e tash ky që e kemi tani në procedurë është një

urgjencë sepse po e parandalojmë likuidimin e “Trepçës”. Ajo se kush i ka fajet se pse i ka fajet, nuk është mirë që ne sot të merremi me klëtë. Por duhet t’ua përkujtojmë se një sfidë të tillë të jashtëzakonshme, sfidë për “Trepçën” e edhe për kredibilitetin e Institucioneve të Kosovës e kemi pasur të ngjashme, ndoshta i kujtohet z.Fatmir Rexhepi, kur e ka udhëhequr Komisionin në vitin 2005, me përfundimin e moratoriumit të vitit 2005 dhe e shoh me optimizëm daljen nga kjo situatë sepse atëherë nuk e kemi pasur pavarësinë e Kosovës, ka qenë Kosova në një status krejt tjetër dhe reagimet e Kuvendit, deputetëve së bashku pozitivë, opozitë e kanë sjellë thjeshtë që “Trepçën” ta parandalojë nga ajo tatëpjetë që e ka pasur në atë kohë.

Sot e kemi shtetin e Kosovës, edhe besoj që është në duart tona dhe do të punojmë sa më shpejt për të mirën e vendit tonë , ë këtë rast edhe të “Trepçës”.

Blerand Stavileci tha se tash po duam ta shkurtojmë argumentin në një pyetje shumë të thjeshtë, e cila do përgjigje të menjëhershme; i kemi 13 ditë, a është sot pikëpyetje pronësia a likuidimi? Likuidimi pra, ne duhet me eliminua likuidimin, për të tjerat mandej edhe të behët analiza, strategjia dhe Ligji për “Trepçën”.

Muhamet Mustafa, kryetar: “Kërkoj që të procedohet më votim në parim, me deklaram vote për aprovim të këtij projektligji dhe për tu diskutuar në seancën plenare të Kuvendit me shmangie të Rregullores, për shkak të urgjencës”.

Pas debatit, Komisioni më 7 vota Për dhe 3 Kundër, nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet në parim, Projektligji Projektligjin Nr.05/L-08 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-035, për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Projektligjit Projektligjin Nr.05/L-08 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-035, për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, të bëhet me procedurë të përshpejtuar-shmangie nga afatet dhe procedurat e parapara me Rregulloren e Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 16:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa